

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	KËRCET ARMA NË SARANDË/ Ekzekutohet Artan Myrtaj nga 2 persona me motor, plagoset dhe një kali mtar
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/krcet-arma-nsarand-ekzekutohet-artan-myrtaj-nga-2-persona-me-motor--i515090
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 08:49:25 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 08:35:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	13e9b4f3d299c04e4f276ac9b2dfde0a474df7baee44c22f6bb7154bf54fe9c3
TEKSTI	1d6cea3554212768ea7e4edad991a64a9894bf66c4755ba6782ec5b1d349209d
PAMJA	f828ee447a5ed5b6f4fa660e3c129c70af9483ed059c6b600816f1b28f566b73

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7fc7e718b354ef0ef303382738bd694a445c609901271387b3e06775c6ac0725
E MËPARSHMJA	947ccb472d5f3a7f37b9fe9b9809fcab247dea0a0132d7c6b26a7caabd57437
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7fc7e718b354ef0ef303382738bd694a445c609901271387b3e06775c6ac0725>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

1 ORE ME PARE

KËRCET ARMA NË SARANDË/
Ekzekutohet Artan Myrtaj nga 2 persona me motor, plagoset dhe një kalimtar

16 ORE ME PARE

112 ditë protesta kundër qeverisë/ Qytetarët mbledhen sërish në Bulevard, kërkojnë ndryshimin e Kodit Zgjedhor

21 ORE ME PARE

"Diaspora është me ne"/ Berisha: Rama është e shkuara, PD duhet të bëjë gjithçka për ripërtëritjen e saj

23 ORE ME PARE

Krim brenda familjes në Tiranë/ I moshuari godet me thikë gruan, 58-vjeçarja ndërrohet jetë në spital. Autori kapet pas disa orësh arrati (EMRAT+ VIDEO)

LIVE UPDATES

KËRCET ARMA NË SARANDË/ Ekzekutohet Artan Myrtaj nga 2 persona me motor, plagoset dhe një kalimtar

• Një atentat me armë zjarri ka ndodhur mëngjesin e sotëm në qendër të Sarandës, pranë ish-agjencisë së vjetër, ku ka mbetur i vrarë 44-vjeçari Artan Myrtaj. • Nga të shtënat është plagosur edhe një kalimtar, ndërsa autorët dyshohet se kanë qenë dy persona që lëviznin me motor dhe mbanin skafandra. • Policia ka nisur hetimet për identifikimin dhe kapjen e autorëve, ndërsa në vendngjarje kanë mbërritur shërbimet e policisë dhe grupi hetimor. • Artan Myrtaj rezultoi me precedent të mëparshëm penal, dhe mësohet të ketë dalë nga burgu para pak kohësh. • Ai ka qenë i përfshirë, në një ngjarje kriminale të ndodhur në vitin 2025, ku mbetën të plagosur dy persona. • Që prej asaj kohe saga e hakëmrarjes vijoi deri në eliminimin e Artan Myrtaj, i cili njihet edhe me nofkën "Tani Ruzhdiut".

9 artikuj për këtë temë.

27 MINUTA ME PARE

Vrasja në Sarandë/ Viktima ishte ulur në lokal para se të ekzekutohej, autorët e qëlluan dy herë me armë zjarri teksa tentoi të largohej



Foto ilustruese

SARANDË- Detaje të reja janë zbardhur nga atentati i sotëm në Sarandë ku viktim mbeti 44-vjeçari Artan Myrtaj. Sipas të dhënave, para se të qëllohej me armë zjarri Myrtaj ishte ulur në një lokal pranë kryqëzimit të ish-agjencisë ku autorët e qëlluan dy herë.

Ata kaluan në rrugën 'Lefter Talo', ndërsa kur viktimja i ka pikasur ka tentuar të largohej me vrap drejt rrugës 'Vangjel Pandi' dhe është vrarë në mes të rrugës. Myrtaj rezultoi si i përfshirë në një ngjarje kriminale të ndodhur në 17 korrik 2025 në lagjen nr.4 të Sarandës, ku u plagosën me armë zjarri Ernest Lama dhe Gëzim Hajdaraj nga Kamza.

Autori i plagosjeve ka qenë Ramadan Zoto, ndërsa Klaus Jaçaj së bashku me Erjon Jaçaj dhe Artan Myrtaj bashkëpunuan me të dhe e ndihmuan pas ngjarjes që të arratisen. Fill pas kësaj ngjarje, në Sarandë ka pasur një sërë episodesh hakmarrjeje, ku Isuf Jaçaj, i ati i Klaus Jaçajt u vra me tritol si dhe ka patur një rast të shkatërrimit të pronës së Ramadan Zoto./Dosja.al

editoriale

Andrey Kortunov

Zgjedhjet në Rusi janë më shumë sesa teatër politik

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Në vëmendje

AKTUALITET 20 SHTATOR 2026, 10:47

Vrasja në Sarandë/ Nëna sheh të birin e pagjetë dhe shpërthen në lot: O djali i nënës (VIDEO)

AKTUALITET 20 SHTATOR 2026, 10:42

VIDEO/ Vrasja në Sarandë, momenti kur kalimtari i

57 MINUTA ME PARE

Vrasja e Artan Myrtajt në qendër të Sarandës, si nisi saga e hakmarrjes pas plagosjes së dy të rinjve nga Kamza



foto ilustruese

SARANDA- Artan Myrtaj, 44-vjeçari që u ekzekutua ditën e sotme në qendër të Sarandës njëhij ndryshe edhe me nofkën "Tani Ruzhdiut". Ai rezulton si i përfshirë në një ngjarje kriminale të ndodhur në 17 korrik 2025 në lagjen nr.4 të Sarandës, ku u plagosën me armë zjarri Ernest Lama dhe Gëzim Hajdaraj nga Kamza.

Autori i plagosjeve ka qënë Ramadan Zoto, ndërsa Klaus Jaçaj së bashku me Erjon Jaçaj dhe Artan Myrtaj bashkëpunuan me të dhe e ndihmuan pas ngjarjes që të arratiset. Fill pas kësaj ngjarje, në Sarandë ka pasur një sërë episodesh hakmarrjeje, ku Isuf Jaçaj, i ati i Klaus Jaçajt u vra me tritol si dhe ka patur një rast të shkatërrimit të pronës së Ramadan Zoto.

Sipas informacioneve paraprake, Ramadan Zoto aktualisht po vuan dënimin me burg për plagosjen e Ernest Lama dhe Gëzim Hajdarajt, ndërsa viktimat e ditës së sotme Artan Myrtaj së bashku me Klaus Jaçaj ishin të akuzuar për "përkrahje të autorit" dhe ishin lënë të lirë para pak kohësh. Mësohet se Myrtaj ishte përdorues i lëndëve narkotike, dhe kishte precedent të mëparshëm penal për 'vjedhje', sakaq, në kërkim mbetet Erjon Canaj./Dosja.al

1 ORE ME PARE

Vrasja e 44-vjeçarit në Sarandë, Policia: Janë ngritur pika kontrolli në drejtim të Vlorës dhe Gjirokastrës



SARANDË- Policia ka ngritur pika kontrolli në drejtim të Vlorës dhe Gjirokastrës, në përpjekje për të kapur autorët e vrasjes së 44-vjeçarit Artan Myrtaj në Sarandë. Nënjaria ka ndodhur rreth orës 09:55. pranë ish-agjencisë, ku 44-vjeçari është

AKTUALITET 20 SHTATOR 2026, 10:17

DETAJET/ Si u vra Artan Myrtaj në Sarandë, u qëllua nga dy persona me motor

më të klikuarat

FOTO/ Kush është Artan Myrtaj që u ekzekutua ditën e sotme, viktimat njëhij si "Tani Ruzhdiut"

"Turp dhe faqe e zezë"/ Zhupa: Hiqeni menjëherë shgarravinën si Çerçiz Topulli në Muzeun e Gjirokastrës! E papranueshme dhe fyese



VIDEO/ Banorët e Divjakës nuk tërhiqen, 51 ditë protestë kundër hartës territoriale: Jo shkrirjes së Bashkisë

"Manipulimi me AI gati sa nuk shkaktoi përplasje SHBA-Kinë", CNN: Ushtria amerikane u përgatit të sulmonte një anije kineze

insights

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka
Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by tomorrow

qëlluar me armë zjarri dhe ka mbetur i vdekur në vend.

Nga të shtënat ka mbetur i plagosur edhe një 73-vjeçar, Xhevdet Skëndaj, i cili ishte kalimtar i rastit dhe është transportuar në spital për të marrë ndihmë mjekësore.

Njoftimi i Policisë:

Rreth orës 09:55, te ish-agjencia, në rrethana ende të paqarta, është vrarë me armë zjarri shtetasi A. M., rreth 44 vjeç, si dhe ka mbetur i plagosur shtetasi Xh. S., rreth 73 vjeç, kalimtar i rastit, i cili është transportuar në spital për ndihmë mjekësore.

Shërbimet e Policisë janë vënë në ndjekje të autorëve. Janë ngritur pika kontrolli në drejtim të Vlorës dhe të Gjirokastrës. Në vendngjarje ka shkuar grupi hetimor dhe, nën drejtimin e Prokurorisë, vijon puna për sqarimin e rrethanave, administrimin e çdo prove që i shërben hetimit, me qëllim identifikimin dhe kapjen e autorëve./Dosja.al

1 ORE ME PARE

Vrasja në Sarandë/ Nëna sheh të birin e pajetë dhe shpërthen në lot: O djali i nënës (VIDEO)



SARANDË- Pamje të rënda vijnë nga vendi i atentatit në qendër të Sarandës, ku mbeti i vrarë 44-vjeçari Artan Myrtaj.



Nëna e 44-vjeçarit ka shpërthyer në lot pasi ka parë të birin të pajetë në vendin e ngjarjes. Në momentet e rënda, një grua dhe një efektivi policie janë përpjekur ta mbajnë atë./Dosja.al

1 ORE ME PARE

VIDEO/ Vrasja në Sarandë, momenti kur kalimtari i plagosur futet në ambulancë

Kalimtar i plagosur futet në ambulancë



SARANDË- Pamje nga vendi i ngjarjes në Sarandë tregojnë momentet pas atentatit me armë zjarri, ku mbeti i vrarë 44-vjeçari Artan Myrtaj dhe u plagos një kalimtar.

Në pamje shihet kalimtari i plagosur teksa nxirret nga vendi i ngjarjes dhe dërgohet me ambulancë për të marrë ndihmë mjekësore.



Ngjarja ndodhi në qendër të Sarandës, pranë ish-agjencisë së vjetër. Autorët dyshohet se ishin dy persona që lëviznin me motor dhe mbanin skafandra./Dosja.al

1 ORE ME PARE

FOTO/ Kush është Artan Myrtaj që u ekzekutua ditën e sotme, viktima njëhej si 'Tani Ruzhdiut'





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.